

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch  
Sulejman Vokshi, No. 14  
Pristina  
Kosovo

Telephone +381 38 246 771  
Telefax +381 38 246 772  
E-mail [al-kosovo@kpmg.com](mailto:al-kosovo@kpmg.com)  
Internet [www.kpmg.al](http://www.kpmg.al)

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË**  
**KAÇANIKUT NË DHE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME**  
**31 DHJETOR 2010**

**Prishtinë, Qershor 2011**

## TABELA E PËRMBAJTJES

I.	Përmbledhje e përgjithshme.....	3
II.	Hyrje .....	5
III.	Opinioni i auditimit.....	7
IV.	Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara .....	10
V.	Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar.....	11
VI.	Pasqyrat financiare.....	12
VI.1	Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm .....	12
VI.2	Cilësia e informatave .....	12
VI.3	Të hyrat ( duke përfshirë ato vetanake) .....	13
VI.4	Shpenzimet.....	14
VI.5	Subvencionet dhe transferet.....	16
VI.6	Pasurit dhe Borxhet.....	16
VII.	Kontrolli i menaxhmentit.....	18
VII.1	Sistemet e Kontrollit të Brendshëm .....	18
VII.2	Komiteti i Auditimit.....	18
<a href="#">VIII.19</a>	Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Komunës së Kaçanikut .....	19
Shtojca I.Komentet e Menaxhmentit të Komunës së Kaçanikut dhe përgjigjja e KPMG-së		20
Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të përdorura nga KPMG në Raportin Vjetor të Auditimit për 2010.....		28

## I. Përmbledhje e përgjithshme

KPMG ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare (PVF) të Komunës së Kaçanikut (“Komuna”) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Instruksioneve Supreme të Auditimit (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Me poshtë gjeni një ekstrakt të marrë nga opinioni i auditimit në faqen 8 të këtij dokumenti.

“Sipas opinionit, përveç të mungesës së informacionit të përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 mbi azat e kualifikimit të opinionit, pasqyrat financiare prezantojnë drejt në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik në baza keshi (‘IPSAS’) për Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit në Baza Keshi dhe me Udhezimit Administrativ Nr. 16/2010 Mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore.”

Mesazhet kryesore ndaj Kryetarit, të cilat çuan në kualifikimin e opinionit tonë, janë:

1. Komuna nuk ka shpalosur shumat complete në lidhje pronat, objektet dhe pajisjet në Shënimi 27 në pasqyrat financiare. Ka disa mangësi dhe pasiguri që ndikojnë raportimin financiar të Komunës për pronat, objektet dhe pajisjet si më poshtë:

- Komuna nuk i ka shpalosur pronat, objektet dhe pajisjet nga Programi i Arsimit.
- Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve të saj.
- Komuna nuk ka një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë.
- Si pasojë e mungesës së dokumentave mbështetës për matjen e një pjese të konsiderueshme të pronave, objekteve dhe pajisjeve, Komuna kërkoi ti masë ato me vlerën e tregut bazuar në vlerësimin e kryera nga një komitet i themeluar mbrenda Komunës. Komiteti nuk është i përbërë nga ndonjë vlerësues i çertifikuar dhe vlerat e prezentuara në pasqyrat financiare nuk janë të mbështetura nga ndonjë report vlerësimi.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve dhe mungesave të tjera të shpjeguara më sipër, ne nuk mundëm të përcaktojmë çfarë rregullimesh mund të ishin të nevojshme për informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Komunës.

2. Informacioni krahasues për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2009 dhe 2008 nuk është i saktë dhe i plotë. Në veçanti, të meposhtmet mungonin ose nuk ishin shpalosur në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare:

- Pagesat nga palët e treta, neni 9 Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme nuk ishte shpalosur për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2009 dhe 2008.

- Informacioni krahasues i prezantuar në shënimet 12 dhe 13 për vitet 2008 nuk janë të plota dhe të sakta.
- Informacioni krahasues, i cili duhet prezantuar në Shënimin 12.1 për vitet 2008 nuk është i plotë.

Meqenëse pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 dhe 2008 morën një refuzim për të dhënë opinion, treguesit krahasues të përshkruar më sipër mund të jenë me anomali materiale.

### **Kontrolli i brendshëm**

Auditimi ynë ka gjetur mangësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto mangësi janë shpjeguar në detaje në brendësi të raportit.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrolleve të brendshme të Komunës nuk janë të dizajnuara në mënyrë të duhur për eliminim e dobësive evidente dhe nuk implementohen në mënyrë të duhur.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, në ju rekomandojmë që të siguroheni që:

- Pasqyrat financiare të prezantohen në përputhje me Udhëzimin administrativ dhe SNKSP;
- Të mbahet një listë e pronave, ndërtesave dhe pajisjeve;
- Të mbahet një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave;
- Të bëhet barazimi i të hyrave në mes zyrtarit të të hyrave vetanake dhe departamenteve operacionale;
- Të merren masa për rritur mbledhjen e të hyrave nga taksa të ndryshme;
- Ligji Nr. 2003/17 ‘Ligji i prokurimit publik në Kosovë (i ndryshuar) të ndiqet në tërësi; dhe
- Të themelohet një komitet auditimi.

Menaxhmenti të Komunës i është dhënë mundësia për të bërë komente mbi gjetjet e prezantuara në këtë raport. Menaxhmenti është pajtuar për të bërë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet në lidhje me të Hyrat dhe themelimin e Komitetit të Auditimit. Menaxhmenti nuk pajtohet me rekomandimin tonë në lidhje Pusurite Kapitale dhe Jo-kapitale. Ndërsa, ata janë pajtuar pjesërisht në lidhje me rekomandimet në fushat e Pasqyrave Financiare, Pagave dhe Mëditjeve dhe Sistemit të Kontrolleve të Brendshme. Ne nuk kemi pranuar komente nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet tona në fushat e Prokurimit, Blerjeve të Tjera dhe Borxheve.

Referohuni në Shtojcen 1 për komentet e menaxhmentit ndaj rekomandimeve tona dhe përgjigjen tonë ndaj tyre.

## II. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e Komunës së Kaçanikut që të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ 16/2010 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

KPMG në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, është përgjegjëse për kryerjen e auditimit vjetor për pasqyrat financiare të Komunës më dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010.

Auditimi është një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe dhënien e sigurisë në lidhje me:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për ndonjë çështje tjetër të rëndësishme të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Kemi kryer auditimin e përkohshëm të Komunës. Gjatë asaj faze të procesit të auditimit, kemi adresuar faktin se si Komuna i ka trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Bazuar në këtë në kemi këshilluar menaxhmetin. Rekomandimet tona po ashtu përfshijnë edhe këshillat e dhëna në lidhje me përmirësimet që pasqyrat financiare të jenë në përputhje me Udhëzimin Administrativ 16/2010 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) për “Raportimin financiar sipas kontabilitetit në baza keshi. Rekomandimet tona janë dorëzuar përmes memorandumit të auditimit, më 8 dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi krahasuar pasqyrat vjetore financiare të Komunës me buxhetin e miratuar për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Komunës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Udhëzimin Administrativ nr 16/2010;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale mbi transaksionet financiare; dhe
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, kontrollimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

Në këtë raport ne përmbledhim gjetjet e auditimit e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare më dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës, ONISA përcakton kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të sqaruara më gjerësisht në Shtojcën 2, e cila përmban një ekstrakt nga ISSAI 4000.

### III. Opinioni i auditimit

#### Raporti i auditorit të pavarur

Për asamblenë e Komunës

Komuna e Kaçanikut, Kosovë

Pristina, 3Qërshor 2011

Ne jemi angazhuar për të audituar pasqyrat financiare përcjellëse të Komunës së Kaçanikut ("Komuna"), që përbëhen nga pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010, një krahasim të shumave të buxhetuara dhe ato aktuale, dhe një përmbledhje të politikave kyëe kontabël dhe shenimeve tjera shpjeguese.

#### *Përgjegjësia e Menaxhimit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ('SNKSP') – Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2010 Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

#### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Në kemi kryer auditimin tonë në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga ONISA (INTOSAI). Këto stadarde kërkojnë që ne të jemi në përputhje me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të mbledhur siguri të arsyeshme në lidhje me, nëse pasqyrat financiare janë pa keqdeklarime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi të auditimit për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi jonë, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne e konsiderojmë kontrollet e brendshme të entitetit në lidhje me përgatitjen e dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë së evidenca e auditimit që në kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për mendimin tonë.

### *Baza për opinion të kualifikuar*

1 Shënimi 27 në pasqyrat financiare shpalos pronat, objektet dhe pajisjet që janë në pronësi të Komunës. Për më tepër, ka disa mangësi dhe pasiguri që ndikojnë raportimin financiar të Komunës për pronat, objektet dhe pajisjet si më poshtë:

- Komuna nuk i ka shpalosur pronat, objektet dhe pajisjet nga Programi i Arsimit.
- Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve të saj.
- Komuna nuk ka një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë.
- Si pasojë e mungesës së dokumentave mbështetës për matjen e një pjese të konsiderueshme të pronave, objekteve dhe pajisjeve, Komuna kërkoi ti masë ato me vlerën e tregut bazuar në vlerësimet e kryera nga një komitet i themeluar mbrenda Komunës. Komiteti nuk është i përbërë nga ndonjë vlerësues i çertifikuar dhe vlerat e prezantuara në pasqyrat financiare nuk janë të mbështetura nga ndonjë report vlerësimi.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve dhe mungesave të tjera të shpjeguara më sipër, në nuk mundëm të përcaktojmë çfarë rregullimesh mund të ishin të nevojshme për informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Komunës.

2 Informacioni krahasues për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2009 dhe 2008 nuk është i saktë dhe i plotë. Në veçanti, të mëposhtmet mungonin ose nuk ishin shpalosur në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare:

- Pagesat nga palët e treta, neni 9 Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme nuk ishte shpalosur për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2009 dhe 2008.
- Informacioni krahasues i prezantuar në shënimet 12 dhe 13 për vitin 2008 nuk është i plotë dhe i saktë.
- Informacioni krahasues, i cili duhet prezantuar në Shënimin 12.1 për vitin 2008 nuk është i plotë.

Meqenëse pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 dhe 2008 morën një refuzim për të dhënë opinion, treguesit krahasues të përshkruar më sipër mund të jenë me anomalitë materiale.

### *Opinion i kualifikuar*

Sipas opinionit, përveç mungesës së informacionit të përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të paragrafit mbi bazat e kualifikimit të opinionit, pasqyrat financiare prezantojnë drejt në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik në baza keshi ('IPSAS') për *Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit në Baza Keshi* dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2010 *Mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore*.

### **Rishikimi i përputhshmërisë**

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qëverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.”



## *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 *Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale me autoritetet që i qëverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

## *Konkluzion për Përputhshmërinë*

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë rishikimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qëverisin ato.

## *Çështje të tjera*

Ne tërheqim vëmendjen për si më poshtë:

- 1 Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Sidoqoftë, pasi që Free Balance nuk përdoret për të regjistruar pagesat nga palët e treta dhe faturat e papaguara, ai nuk mund të përdoret për të prodhuar pasqyra financiare gjithëpërfshirëse.”
- 2 Pasiqë Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës, mund të ketë pasiguri në lidhje me plotësinë e të arkëtueshmeve dhe të hyrave që Komuna mund të fitojë dhe në aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore.
- 3 Ne kemi identifikuar një numër mospërputhshjesh me Ligjin Nr. 2003/17 ‘Ligji i Prokurimit Publik’ (i ndryshuar). Mospërputhje të tilla janë të lidhura me procedurat e kërkuara të cilat Komuna nuk i ka kryer dhe dokumentuar.
- 4 Megjithëse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe pagesa të parasë së gatshme të mund të kërkojnë në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka vendosur ndonjë proces formal që mund të sigurojë informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontigjente.

*KPMG Albania SHPK Kosovo Branch*

KPMG Albania Sh.p.k. – Kosovo Branch  
Rruga Sulejman Vokshi, 14  
Prishtine  
Kosove

## **IV. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara**

Në raportin tonë të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të vitit 2009 janë dhënë gjashtë rekomandime kryesore. Asnjë nga këto rekomandime nuk është adresuar dhe janë përfshirë më poshtë:

- Pasqyrat Financiare duhen përgatitur në përputhje me udhëzimet administrative aktuale dhe SNKSP;
- Të mbahet një listë e plotë e pronave, objekteve dhe pajisjeve të Komunës;
- Ne kemi identifikuar një numër mos-pajtueshmëri në fushën e shpenzimeve, duke përfshirë mos-pajtueshmëritë me “Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë” Ligji Nr 2003/17 (i ndryshuar), mos-pajtueshmëritë në fushën e pagave dhe mëditjeve dhe të blerjeve tjera. Këto mos-pajtueshmëri lidhen me procedurat që kërkohen, të cilat nuk ishin kryer dhe dokumentuar nga Komuna.
- Të vendoset një sistem faturimi për të gjitha llojet e taksave, të barazohen të hyrat në mes zyrtarit të të hyrave vetanake dhe departamenteve operacionale dhe duhet të merren masa për të ngritur mbledhjen e të hyrave nga taksa të ndryshme.
- Të themelohet një Komitet i Auditimit.

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona, ka bërë që ne të kemi të njëjtat gjetje si në vitin 2009.

## V. Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare krahasuar me Buxhetin e Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxhetit dhe shpenzimeve aktuale

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	2010 Realizimi	2009 Realizimi
Grandi i qëverisë – Buxheti	3,830,000	3,981,000	3,981,000	3,950,000	3,419,000
Të hyrat vetjake	549,000	549,000	634,000	432,000	576,000
Donacionet e vendit	-	-	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	-	30,000	22,000	68,000
<b>I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve</b>	<b>4,379,000</b>	<b>4,530,000</b>	<b>4,645,000</b>	<b>4,404,000</b>	<b>4,063,000</b>
Rrogat dhe pagat	2,621,000	2,761,000	2,788,000	2,769,000	2,501,000
Mallra dhe shërbime	371,000	366,000	458,000	454,000	370,000
Shpenzimet komunale	81,000	82,000	93,000	87,000	80,000
Subvencionet dhe transferet	41,000	41,000	61,000	61,000	79,000
Investimet Kapitale	1,265,000	1,280,000	1,245,000	1,033,000	1,033,000
Rezervat	-	-	-	-	-
<b>II. Gjithsej shpenzimet</b>	<b>4,379,000</b>	<b>4,530,000</b>	<b>4,645,000</b>	<b>4,404,000</b>	<b>4,063,000</b>
<b>Ndryshimi I-II</b>	-	-	-	-	-

Shumat e buxhetuara janë ekstraktuar nga nenet e më poshtme të pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010: Neni 10 –Raporti i ekzekutimit të buxhetit dhe Neni 17 Shënimi 31 Barazimi në mes të ndarjeve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit.

## **VI. Pasqyrat financiare**

### **VI.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm**

Bazuar në kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ 16/2010, në kemi identifikuar pikat në vijim:

- Komuna nuk ka përgatitur pasqyrat financiare në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ nr. 16/2010 përveç kompletësisë së shpalosjeve të pronës, objekteve dhe pajisjeve në shënimin 27 të pasqyrave financiare;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar i entitetit të audituar;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 29/01/2011 dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (“MEF”);
- Pasqyrat Financiare janë dorëzuar në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek MEF gjatë vitit 2010.

#### **Rekomandimi 1**

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për tu siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyrat financiare.

### **VI.2 Cilësia e informatave**

#### **Të Gjeturat**

Gjetjet dhe rekomandimet tona përgjatë këtij dokumenti tregojnë përmirësimet që duhet të bëhen në kualitetin e informacioneve të pranuar dhe prezantuar në pasqyrat financiare nga ana e Komunës.

#### **Rekomandimi 2**

Ju lutem shihni rekomandimet përgjatë këtij dokumenti për këshillat se si kualiteti i informacionit mund të përmirësohet.

## VI.3 Të hyrat ( duke përfshirë ato vetanake)

### Të Gjeturat

- *Sistemi i faturimit.* Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për tatimin në pronë. Komuna nuk mban regjistra të faturimit për llojet tjera të të hyrave. Për këto të hyra regjistrohen vetëm arkëtimet e parave të gatshme.
- *Mbledhja e të hyrave.* Përveç tatimit mbi pronën, Menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra të ndarë ose ndonjë listë të të gjithë debitorëve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Pa të dhëna të detajuara, të sakta dhe të mjaftueshme të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë normën e saktë të mbledhshmërisë ose të përcjellë në kohë mbledhjen e të hyrave vetanake.
- *Barazimi i të hyrave.* Zyra e taksave administrative, zyra e kadastrit dhe zyra e planifikimit urban nuk kanë bërë barazime të rregullta me departamentin e kontabilitetit për të hyrat e mbledhura.
- *Dobësitë në sistemin e faturimit automatik.* Sistemi i faturimit të tatimit mbi pronën ishte i centralizuar dhe Komuna nuk mund të rishikojë dhe monitorojë në mënyrë të duhur mbledhjen e të hyrave pasi që ajo bëhet në mënyrë automatike nga sistemi.

### **Rekomandimi 3**

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurta, efçiente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me këto sisteme do të mundësonte menaxhmentit të monitoroj dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurojë që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë komunës të konsideroj pikat si në vijim:

- Implementimin e një sistemi të faturimit që përfshin detaje të përditësuara për paguesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pagues. Qasje në informacion të tillë duhet të kenë vetëm një numër të limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti.
- Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifat dhe normat e taksave në sistem në mënyrë që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.
- Të ekzistojë një lidhje automatike në mes të sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit.
- Të ushtrojë barazime të rregullta midis dy sistemeve në periudha të rregullta për të gjitha tipet e të hyrave. Në rastet kur ka diferenca, ato duhet të hulumtohen dhe të zgjidhen brenda afatit të caktuar.
- Te lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta në mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksionesh.

## VI.4 Shpenzimet

### 4.1 Blerjet përmes prokurimit

#### Të Gjeturat

Gjatë inspektimit tonë të dokumenteve për mostren tonë të dosjeve të prokurimit në kemi vënë re se disa mospërputhje me procedurat siç kërkohen nga Ligji për Prokurim Publik (LPP) PL 2003/17. Këto mospërputhje janë përshkruar më poshtë:

- Ne vume re së "Deklarata për përcaktimin e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve", nuk është e plotësuar, siç kërkohet nga ligji për prokurimet e mëposhtme: KA652/10/012/521; KA652/10/015/521; KA652/10/019/521; KA652/10/018/521; KA652/10/031/521; KA652/09/001/136; KA652/09/040/121; KA652/10/047/121; KA652/10/065/136; KA652/10/052/521 dhe KA652/10/051/236.
- Garancia për ekzekutimin e kontratës për prokurimin nr. KA652/09/040/121 nuk ishte në dosje, edhe pse kjo ishte kërkuar në dosjen e tenderit.
- Deklarata nën betim" për komisionin për vlerësimin e tenderëve për prokurimin nr. KA652/10/031/521 ishte e nënshkruar më 09 korrik 2010, ndërsa vlerësimi është bërë me 07 korrik 2010, para nënshkrimit të kësaj deklarate.
- Për procedurat e prokurimit me nr. KA652/10/012/521 dhe KA652/10/019/521, pavarësisht vonesave të konsiderueshme, Komuna nuk ka ushtruar të drejtën e saj për të ngarkuar komisionet/gjobat për vonesë, edhe pse sipas kontratës, Komuna kishte të drejtë të vendoste gjoba nga 0.1% në ditë deri në një maksimum prej 10% të vlerës së kontratës. Nuk kishte ndonjë dokument për të mbështetur vendimin për të mos e ngarkuar ofruesin.
- Nuk na është ofruar formulari standard për vlerësimin e ofertave për prokurimin nr. KA652/09/040/121, në vend të kësaj ka pasur vetëm një procesverbal i nënshkruar nga komisioni i vlerësimit.
- Për prokurimin nr. KA652/10/015/521, formulari standard për vlerësim të ofertave nuk është nënshkruar nga njëri anëtar i komisionit.
- Regjistri i operatorëve që e kanë marrë dosjen e tenderit mungonte për prokurimet e mëposhtme: KA652/10/015/521; KA652/10/019/521; KA652/10/018/521; KA652/10/052/521 dhe KA652/10/047/121.
- Per prokurimet KA652/10/052/521 dhe KA652/10/047/121, fituesi nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit për shkak të mos përmbushjes së dokumenteve të kerkuara nga fituesi i tenderit.
- Nga puna audituese mbi Shpenzimet Kapitale ne kemi gjetur që pagesa në shumë prej EUR 22,160 ishte e paguar gabimisht nga kjo kategori në vend të paguhej nga kategoria donacioneve. Kjo shumë i është dhënë si donacion për bujqësi një organizate jo-qeveritare "Grupi Lokal i Veprimt-Syri i Sharrit", e cila ka nënshkruar një marrëveshje me Komunën për të shpërndar këto fonde tek farmerët lokal të Komunës, për të mbështetur nevojat e tyre për mbjelljen e grurit dhe fidaneve të molleve.

#### **Rekomandimi 4**

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

## 4.2 Blerjet tjera

### Të Gjeturat

Komuna ka themeluar Fondin për Manifestime Komunale ("Fondi"). Ky fond shfrytëzohet për të financuar ngjarje të ndryshme kulturore gjatë vitit. Gjatë rishikimit të dokumentacionit, ky Fond është krijuar nga Organizata e Veteranëve të Luftës me rekomandimin nr. 430/08 të Kryetarit të Komunës të datës 29 Shkurt 2008. Personat e autorizuar për menaxhimin me mjetet e këtij fondi janë Kryetari i Fondacionit dhe njëri nga dy anëtarët e Këshillit Organizativ të Fondit (një nga të cilët është pjesë e menaxhmentit të Komunës).

Sipas Rregullës 2, subvencionet mund ti paguhen entiteteve private dhe publike, të cilat janë të pavarura nga Komuna. Komuna nuk ka qënë në pajtueshmëri me këtë rregull sepse pjesetari i menaxhmentit të Komunës është një nga personat e autorizuar për menaxhim të këtij fondi dhe asnjë pagese ose tërheqje nga ky fond nuk mund të bëhet pa nënshkrimin e tij. Në 2010, Komuna ka vazhduar për të bërë pagesa në këtë fond. Gjatë auditimit për vitin 2010 ne jemi informuar që anëtari i menaxhmentit të Komunës është dorëhequr nga fondi. Sidoqoftë, ne nuk na është ofruar evidence për një veprim të tillë.

Gjate vitit 2010 kishte vetëm një pagesë të bërë ndaj fondit për festimet e Komunës në shumë prej EUR 4,000.

### **Rekomandimi 5**

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontroleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plote me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

## 4.3 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)

### Të Gjeturat

- Komuna nuk ka një sistem për pagat i cili mund të përdoret si informacion i besueshëm për ti mbështetur të dhënat në pasqyrat financiare. Në vend të kësaj, si informacion kryesor dhe i besueshëm përdoren listat e pagave të dërguara nga Ministria e Administratës Publike.
- Ne dosjet e personelit që ishin pjesë e mostrës tonë, ne identifikuam si në vijim:
  - Dy punonjës me iniciale FK dhe BR nuk ishin të pranishëm në listen e pagave të siguruara nga Ministria e Administratës Publike edhe pse ata ishin punësuar në Shtator 2010 dhe në Tetor 2010 përkatësisht. Mos prania në listen e pagave është një indikacion që punetorëve nuk u është paguar paga mujore. Zyrtari i personelit nuk na ka ofruar ndonjë shpjegim se pse ndodhi kjo.
  - Përshkrimi i punës mungonte në katër raste (iniciale: FK, BR, BS dhe ED).
  - Dy punonjës (iniciale: LT dhe XhS), njëri i përjashtuar më 3 qershor 2010 dhe i dyti i dorëhequr më 24 Qusht 2010 nuk ishin të pranishëm fare në listat e pagave të siguruara nga Ministria e Administratës Publike. Mos prania në listen e pagave është një indikacion që punetoreve nuk u është paguar paga mujore.
  - Për pagesën e pagave të stafit të Komunës, urdhër obligimi për pagesë (UOP) duhet të jetë i nënshkruar nga tre zyrtare dhe të dërgohet tek Ministria e Ekonomisë dhe Financave-

Departamenti i Thesarit. Në kemi vërejtur së ky dokument për muajin Maj 2010 nuk është nënshkruar në tre raste, ndërsa në tre raste të tjera ai është nënshkruar vetëm nga një zyrtar.

### **Rekomandimi 6**

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

## **VI.5 Subvencionet dhe transferet**

### **Të Gjeturat**

Nuk ka gjetje për të raportuar në këtë fushë.

## **VI.6 Pasuritë dhe Borxhet**

### **6.1 Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj**

#### **Të Gjeturat**

Nuk ka gjetje për të raportuar.

### **6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve**

#### **Të Gjeturat**

Nuk ka gjetje për të raportuar.

### **6.3 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale**

#### **Të Gjeturat**

Komuna nuk ka mbajtur një regjistër të pronave, objekteve dhe pajisjeve në posedim të saj deri me 31 Dhjetor 2010.

Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të patundshmërive, përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë mbi patundshmëritë, dhe informacion për statusin e regjistrimit në emrin e Komunës në Kadastër për patundshmëri ose në Gjykatë.

Megjithëse Komuna ka krijuar në vitin 2009 një komitet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive, regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë nga Komuna nuk ka filluar ende. Ky komitet nuk ka përfunduar punën dhe si pasojë pasuritë nuk janë regjistruar apo vlerësuar deri me 31 Dhjetor 2010.

Numërimi fizik i pasurisë nuk është bërë në 2010, dhe pa një numërim të tillë në nuk do të jemi në gjendje që të verifikojmë ekzistencën fizike të pasurive.



### **Rekomandimi 7**

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të konsideroje si me poshte:

- Të mbaje një regjistër gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve.
- Të përfshije burime shtese në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe çertifikuar është e rekomandueshme si praktika më e mirë në raste të tilla.
- Të bëjë numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër.
- Të bëjë përpjekje shtesë në lidhje me konfirmimin e pronësisë dhe regjistrimin e patundshmërive.

## **6.4 Borxhet**

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2010 ishte në vlerë prej EUR 23,098. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2011.

### **Te Gjeturat**

Neni 13.1 I Udhëzimit Administrativ Nr.16 / 2010 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore thekson që: *“Për të gjitha mallrat dhe shërbimet e pranuar, pavarësisht kategorisë ekonomike, organizatat buxhetore duhet që të paguajnë të gjitha deri në fund të vitit fiskal – 31 dhjetor 2010.* Ne kemi vënë re që Komuna i ka paraqitur faturat e papaguara në lidhje me mallrat dhe shërbimet në nenin 13, Shenimi 25 të pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2010.

Dhënia e informacioneve shpjeguese në shënimin 25, "Pasqyra e faturave të papaguara" nuk janë të plota dhe të sakta, siç kërkohet nga UA 16/2010 udhëzim administrativ. Gjatë testimit tonë ne kemi vërejtur 3 raste e faturave të papaguara deri më 31 dhjetor 2010, të cilat nuk janë përfshirë në listën e faturave të papaguara në shënimin 25. Përveç kësaj, të gjitha informatat janë paraqitur në tabelën në pikën a) SIMFK të dhënat, dhe asnjë informacion nuk është paraqitur në tabelat përkatëse, sipas pikës b) Detyrimet të tjera.

### **Rekomandimi 8**

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtjshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale. Të gjitha përpjekjet duhet të bëhen për të bërë këto pagesa brenda vitit.

## VII. Kontrolli i menaxhmentit

### VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

#### Të Gjeturat

Informacion parësor në të cilin Komuna mbështetet për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është Free Balance. Meqenëse Free Balance nuk është duke u përdorur për të regjistruar pagesat nga palët e treta, pronës, objekteve dhe pajisjeve, apo faturat e papaguara, nuk mund të përdoret për të prodhuar pasqyra financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010.

Si pasojë e dobësive më lart, edhe pse Komuna ishte në gjendje të paraqesë pagesat nga palët e treta në pasqyrat financiare të bazuara në të dhënat që mbahen manualisht, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2010:

- Neni 16, Shënimi 27. 'Pasuritë Jo-financiare';

#### **Rekomandimi 9**

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për tu siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyrat financiare.

### VII.2 Komiteti i Auditimit

#### Të Gjeturat

Komuna nuk ka themeluar ende një komitet të auditimit.

#### **Rekomandimi 10**

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që të konsiderojë krijimin e një Komiteti Auditimi me anëtarë që kanë eksperiencë të lidhur me raportimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standart të lartë 'udhëheqje të korporatës'. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime në sa më poshtë:

- Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhimi;
- Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore;
- Plani i auditimit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditimit të brendshëm.

## **VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Komunës së Kaçanikut**

### **Konkluzionet e përgjithshme**

Ju lutem shih opinionin e auditorit.

#### **Rekomandimi i përgjithshëm**

- Pasqyrat financiare duhet të përgaditen në përputhje me Udhëzimin administrativ dhe SNKSP.
- Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve të saj.
- Duhet të vendoset një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave, duhet të bëhen barazimet në mes zyrtarit të të hyrave dhe departamenteve operacionle dhe duhet të merren masa për shtuar mbledhjen e të hyrave nga taksat e ndryshme, dhe
- Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të përmiresuar procesin e shpenzimeve.
- Komiteti i auditimit duhet të themelohet.

## Shtojca I. Komentet e Menaxhmentit të Komunës së Kaçanikut dhe përgjigjja e KPMG-së

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p><b>Rekomandimi 1:</b> Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për tu siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyrat financiare.</p>		X		<p>Ne i kemi shpalosur pagesat nga Palët e Treta në shumë prej EUR 327 mijë në Nenin 9 Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave të Parave të Gatshme dhe në shënimin 4. -Pranimet tjera.</p> <p>Krahas këtij shënimi, ne ju kemi dërguar detaje plotësuese me të dhënat e për të gjithë donatorët dhe shumat e paguara sipas projektit dhe konfirmimet për përfundimin e këtyre projekteve të financuara nga palët e treta.</p>	Komuna nuk e ka adresuar gjetjen në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare.

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p><b>Rekomandimi 3:</b></p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyre që të siguroj kontrole të sigurta, eficiente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me këto sisteme do ti mundësonte menaxhmentit të monitoroj dhe menaxhoj rreziqet e mëdha dhe të siguroj që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. në i rekomandojmë komunës të konsideroj pikat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Implementimin e një sistemi të faturimit që përfshin detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes se të hyrave nga këta pages. Qasje në informacion të tillë duhet të kenë vetëm një numër të limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti.</li> <li>• Të vendosë dhe të kontrolloj nga qendra tarifave dhe normat e taksave në sistem në mënyrë që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.</li> <li>• Të ekzistojë një lidhje automatike në mes të sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyre që informacioni të procesohet</li> </ul>	X			<p>Jemi duke bërë përpjekje që të instalohet një softuer, ku do të faturoheshin të gjitha ngarkesat për debitorët e Komunës; dhe që të egzistoj lidhja në mes të drejtorive që krijojnë të hyra dhe të njëjtat të barazohen me kontabilitetin e organizatës buxhetore.</p> <p>Në këtë kontekst, të gjitha Komunitatet të cilat ballafaqohen problemin e kësaj natyre, e kemi ngritur këtë çështje në takimet Kolegjiumit të Drejtorëve për Buxhet dhe Financa (KDBF), i cili funksionon në përbërje të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK). Po ashtu, kemi kërkuar nga AKK-ja që në afatin sa më të shkurtër, duke bërë trysni te Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) për gjetur mbështetje e tyre, të tejkalojmë njëherë e përgjithmonë këtë parregullësi.</p>	Komuna është pajtuar me gjetjet tona.

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p><b>Rekomandimi 3 (vazhdim):</b>  automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të ushtrojë barazime të rregullta midis dy sistemeve në periudha të rregullta për të gjitha tipet e të hyrave. në rastet kur ka diferenca, ato duhet të hulumtohen dhe të zgjidhen brenda afatit të caktuar.</li> <li>Te lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta në mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksionesh.</li> </ul>					
<p><b>Rekomandimi 4:</b>  Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plote me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.</p>					Nuk kemi pranuar përgjigje nga Komuna.
<p><b>Rekomandimi 5:</b>  Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plote me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.</p>					Nuk kemi pranuar përgjigje nga Komuna.

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p><b>Rekomandimi 6:</b> Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plote me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.</p>		X		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ne pajtohemi me rekomandimin në lidhje me mungesën e përshkrimit të punës në katër rastet e evidentuara nga ju;</li> <li>• Dy punonjësit me inicialet LT dhe XHS, nuk kanë mundur të jenë në listat e pagave, sepse ata janë larguar nga listat pas ndërprejres së punës: (XhS pas muajit Qershor 2010 dhe LH pas muajit Gusht 2010.</li> <li>• Përveç listave të pagave, Komuna shërbehet kryesisht me UOP-të si informacion primar rreth shpenzimeve për paga dhe mëditje, sepse përlllogaritja dhe pagesa e tyre autorizohet</li> </ul>	Komuna është pajtuar pjesërisht.

Rekomandimet	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
Rekomandimi 6 (vazhdimi):				<p>vetëm nga Departamenti përkatës i Ministrisë së Administratës Publike (MAP).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• UOP-të nënshkruhen nga dy zyrtarë të organizatës buxhetore (Komunes),ndërsa zyrtari i tretë – Zyrtari autorizues i Thesarit është kompetencë qendrore, prandaj konsiderojmë së kjo çështje duhet të adresohet tek niveli qendror si parregullësi e tyre e bartur tek ne.</li> </ul>	



Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p><b>Rekomandimi 7:</b></p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të konsideroje si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbaje një regjistër gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve.</li> <li>• Te përfshije burime shtese në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe certifikuar është e rekomandueshme si praktika me e mire në raste të tilla.</li> <li>• Te beje numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër.</li> <li>• Te beje përpjekje shtese në lidhje me konfirmimin e pronësisë dhe regjistrimin e patundshmërive.</li> </ul>			X	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuna e ka mbajtur regjistrin e pronave, objekteve dhe pajimeve për Administratën Komunale dhe Shëndetësinë, duke përfshirë dokumentacionin përkates, informatat dhe statusin e pronës, përpos pronave nga programi e Arsimit;</li> <li>• Regjistrimi i pronës në fund të vitit 2010 është kryer nga komisioni i formuar me vendim të Kryetarit të komunës dhe për këtë egzistojnë raportet me shkrim;</li> <li>• Komuna ka caktuar zyrtarin përkatës për regjistrimin e pasurive në SIMFK dhe se i njëjti është duke i përpunuar të dhënat në këtë sistem unik në nivel të vendit.</li> </ul>	Komuna nuk është pajtuar me gjetjet tona.

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p><b>Rekomandimi 8:</b></p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plote me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale. të gjitha përpjekjet duhet të behen që të gjitha pagesat të behen brenda vitit.</p>					<p>Nuk kemi pranuar përgjigje nga Komuna.</p>
<p><b>Rekomandimi 9:</b></p> <p>Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për tu siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyrat financiare.</p> <p>Ne lidhje me kompletësine e pagesave nga palet e treta, në rekomandojmë që Komuna të marrë informacione nga Ministri të ndryshme të cilat kane regjistruar për këto pagesa, dhe të përditesoj regjistrat e saj.</p>				<p>Sistemi i Free-Balance (SIMFK-së) nuk mundëson që pagesat e bëra nga palët e treta të regjistrohen në këtë sistem, prandaj të dhënat e përfshira në pasqyra financiare janë prezantuar nga donacionet e palëve të treta të cilët kanë kontribuar në pasurinë e komunës.</p>	<p>Komuna nuk e ka adresuar gjetjen mbi përgaditjen e pasqyrave financiare.</p>

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p><b>Rekomandimi 10:</b></p> <p>Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që të konsiderojë krijimin e një Komiteti Auditimi me anëtarë që kanë eksperiencë të lidhur me raportimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standart të lartë ‘udhëheqje të korporatës’. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime në sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës;</li> <li>• Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhimi;</li> <li>• Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;</li> <li>• Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore;</li> <li>• Plani i auditit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditit të brendshëm.</li> </ul>				<p>Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit pas marrjes së rekomandimit nga auditimi i vitit 2009, ka inicuar aktivitetin për përgatitjen e të gjitha procedurave për themelimin e Komitetit të Auditimit. Në këtë kontekst, në kemi përpunuar si më poshtë: Ligji nr.03/L-128 Për Auditimin e Brendshëm; Udhëzimi Administrativ i MEF-it nr.11/2010; Doracaku i Auditimit të Brendshëm i MEF-it, i publikuar në dhjetor 2008 dhe Model-Satuti i funksionimit të Komitetit të Auditimit. Përpos përpunimeve të tilla, ende nuk e kemi themeluar këtë komitet në Kuvend, ngase jemi në pritje për themelimin e disa komiteteve brenda Komunës, të cilat do të aprovohen nga Kuvendi.</p>	<p>Komuna pajtohet me gjetjet tona.</p>

## Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të përdorura nga KPMG në Raportin Vjetor të Auditimit për 2010

(E shkëputur nga ISSAI 4000)

**9.** Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

**10. Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
